



Republika e Kosovës
Republika Kosova
Republic of Kosova



Komuna e Kamenicës
Opstina Kamenica
Kamenica Municipality



Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212, Nenit 5, pikës c. të Ligjit Nr. 03/L-068 për Arsimin në Komunitatet e Republikës së Kosovës, Nenit 2, paragrafi 1 të Udhëzimit Administrativ Nr. 17/2009 për Procedurën e Zgjedhjes së Personelit Arsimor në Shkollë dhe Nenit 4 të Udhëzimit Administrativ (MPMS) 07/2017 për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik:

DREJTORIA KOMUNALE E ARSIMIT SHPALL:

K O N K U R S

PËR VENDET E PUNËS:

Niveli	Pozita	Vend i Lirë/Zëvendësim	Numri i pozitave	Periudha e Angazhimit
ShFMU	Mësimdhënës për Lëndën e Biologjisë	Vend i lirë	1	Kohëzgjatje e caktuar deri më 30.06.2019
ShML	Mësimdhënës për Lëndën e Gjuhës Shqipe	Zëvendësim	1	Kohëzgjatje e caktuar deri më 30.06.2019

1. Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës për Lëndën e Biologjisë:
Niveli Master-Arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
Sistemi katërvjeçar
Baçelor (katërvjeçar, 240 ECTS)
2. Kriteret e kualifikimit për Mësimdhënës për Lëndën e Gjuhës Shqipe:
Niveli Master-Arsimor, Fakulteti i Edukimit (300 ECTS)
Sistemi katërvjeçar
Baçelor (katërvjeçar, 240 ECTS)

3. Aplikacioni i kompletuar duhet të ketë këto dokumente:
- Formulari i aplikimit i plotësuar (merret në Komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë)
 - Rezymeja personale (CV)
 - Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë)
 - Diplomat e kualifikimit (ose çertifikatat), çertifikatat në vend të diplomës duhet të jenë të noterizuara te noteri
 - Çertifikatat e trajnimeve të akredituara nga MASHT, të tjerat nuk do të merren parasysh gjatë procedurës së para-seleksionimit
 - Dëshmi të përvojës së punës vetëm në institucione arsimore (vetëm kontrata ose vërtetimi i protokolluar nga punëdhënësi do të merren parasysh), në të kundërtën asnjë dokument tjetër nuk do të jetë relevant për para-seleksionim.
4. Kushtet dhe kriteret e përzgjedhjes së kandidatëve: Përzgjedhja e kandidatëve do të bëhet në bazë të kriterëve të përcaktuara nga DKA në përputhje me Ligjet që e rregullojnë fushën e arsimit parauniversitar dhe në përputhje me Udhëzimet Administrative përkatëse. Kandidatët e kualifikuar me drejtime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim.
5. Sqarime shtesë: Të gjitha dokumentet duhet të jenë kopje dhe ato nuk kthehen, ndërsa origjinalet do të kërkohen me rastin e intervistimit. Mosplotësimi i saktë dhe i qartë i formularit të aplikimit, aplikacionet e pakompletuara dhe ato që dorëzohen pas afatit të konkursit nuk do të merren në shqyrtim. Si informata të sakta dhe të vërteta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi). Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuara diplomat nga MASHT.
6. Për intervistë do të ftohen ata kandidatë të cilët i plotësojnë kushtet. Lista e ngushtë e aplikantëve që ftohen për intervistë (me shkrim dhe me gojë) dhe orari i intervistave publikohet në ëeb faqen e Komunës së Kamenicës.

Konkursi mbetet i hapur 8 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik. Aplikacioni i kompletuar (me të gjitha dokumentet e kërkuara) duhet të dorëzohet në Qendrën për Shërbime me Qytetarë, në objektin e Komunës së Kamenicës.

U.D. Drejtor i Drejtorisë Komunale të Arsimit

Mirhane Morina

